

BULETIN JAVOR

1-4 GUSHT 2023



Shprehja

"Siguria në IT është si të kyçësh shtëpinë ose makinën tënde – nuk i ndalon njerëzit e këqij, por nëse është mjaft e mirë, ata mund të shkojnë drejt një objekti më të lehtë."

Paul Herbka

e javës

Përmbajtja:

- Aplikacione keqdashëse përdorin teknika të avancuara në Google Play store
- FBI, CISA dhe NSA zbulojnë vulnerabilitetet më të shfrytëzuara të vitit 2022
- Zbulohet një malware i ri i identifikuar si WikiLoader
- Goole Chrome - Patching Alert



Aplikacione keqdashëse përdorin teknika të avancuara në Google Play store

Aktorët e kërcënimit po përdorin një teknikë të quajtur versionimi për të shmangur zbulimet e malware të Google Play Store dhe për të synuar përdoruesit e Android.

Me këtë metodë, një developer lëshon versionin fillestar të një aplikacioni në Play Store duke kaluar kontrollet e sigurisë e para-publikimit të Google, por më vonë përditësohet me një komponent malware.

Për të zbutur çdo rrezik të mundshëm, rekomandohet që përdoruesit e Android t'i përmbahen burimeve të besuara për shkarkimin e aplikacioneve dhe të mundësojnë që Google Play Protect të marrë njoftime kur një aplikacion potencialisht i dëmshëm (PHA) gjendet në pajisje.

[Link: Lexo më shumë](#)



FBI, CISA dhe NSA zbulojnë vulnerabilitetet më të shfrytëzuara të vitit 2022

Në bashkëpunim me CISA, NSA dhe FBI, autoritetet e sigurisë kibernetike Five Eyes kanë publikuar një listë me 12 vulnerabilitetet më të shfrytëzuara gjatë vitit 2022.

Agjencitë e sigurisë kibernetike në Shtetet e Bashkuara, Australi, Kanada, Zelandën e Re dhe Mbretërinë e Bashkuar u bënë thirrje organizatave në mbarë botën që të adresojnë këto të meta sigurie dhe të vendosin sisteme të menaxhimi për të minimizuar ekspozimin e tyre ndaj sulmeve të mundshme.

[Lexo më shumë](#)



Zbulohet një malware i ri i identifikuar si WikiLoader

Studiuesit e Proofpoint kanë identifikuar një malware të ri, të quajtur WikiLoaderi cili është zbuluar në të paktën tetë fushata që synojnë organizatat italiane që nga dhjetori 2022.

Këto fushata përdorin emailë që përmbajnë bashkëngjitjet e Microsoft Excel, bashkëngjitjet e Microsoft OneNote ose bashkëngjitjet PDF, duke shkaktuar shkarkimin e Trojanit Ursnif si një ngarkesë shtesë.

[Link: Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT

New in

Chrome

115

Google lançon një përditësim të Chrome 115 që rregullon 17 vulnerabilitete, prej të cilave 11 janë të raportuara nga studiues të jashtëm.

Përditësimi rregullon tre defekte të vlerësuara me rrezik të lartë në motorin V8 JavaScript dhe WebAssembly.

Gjigandi i internetit nuk përmend asnjë nga dobësitë e sapozgjidhura të jenë shfrytëzuar në sulme me qëllim të keq.

AKCESK rekomandon të gjithë përdoruesit e Chrome që të instalojnë versionin e përditësuar.

[Link: Lexo më shumë](#)